



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	02/12/2013
REFERENC-Ë:	AKK - DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Zize BLAKAJ-BUJUPAJ Menaxhere e Prokurimit në Komunën e Istogut
CC:	z. Haki RUGOVA Kryetar i Komunës së Istogut
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion për Tenderin: "Furnizimi-Blerja e fidanëve për ngritjen e pemishteve"



Të nderuar!

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin: "Furnizimi - Blerja e fidanëve për ngritjen e pemishteve" me nr. 633-130-65-121-R, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues, që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Furnizimi - Blerja e fidanëve për ngritjen e pemishteve", në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Komuna e Istogut më datë 03/10/2013 përmes KRPP-së ka shpallur “Njoftim për Kontratë” për tenderin “Furnizimi - Blerja e fidanëve për ngritjen e pemishteve”, me numër Prokurimi: 633-130-65-121-R. Divizioni i Parandalimit të Korrupsionit në Prokurim Publik, pran Departamentit të Parandalimit në Agjencinë Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë procedurë prokurimi si rast për trajtim. Gjatë ekzaminimit të dokumentacioneve të kësaj procedure të prokurimit, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në përputhje të plotë me procedurat e prokurimit të cilat mund të shpicien drejt shpërblimit me kontratë në bazë jo meritore.

Bazuar tek “Regjistri i Operatorëve që Kanë Pranuar Dosjen e Tenderit” Autoriteti Kontraktues i ka dhënë Dosjen e Tenderit disa Operatorëve Ekonomik para se të shpallet Njoftim për Kontratë. Njoftimi për Kontratë është shpallur më datë **03/10/2013** ndërsa disa nga Operatorët Ekonomik dosjen e kanë tërhequr nga data **15/09/2013**.

Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit tek pika III.2.2 Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar – ka kërkuar qarkullim bankar në tri vitet e fundit (2010,2011,2012), minimumi trefishi i vlerës konkurruese. I njëjti kriter, tek “Raporti i Vlerësimit të Tenderëve” është vënë në rubrikë, por me një ndryshim të viteve, pra tek raporti janë dhënë vitet 2011, 2012 dhe 2013. Me një fjalë është hequr viti 2010, ndërsa është shtuar viti 2013. **Operatori fitues i këtij tenderi, ka ofruar qarkullim bankar në përputhje me ndryshimet që janë bërë nga Autoriteti Kontraktues.**

Në Dosjen e Tenderit, Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik, pika 6.4. nënpika b. Kërkohet: Certifikata nga Instituti përkatës për gjendjen shëndetësore të materialin fidanor – origjinal apo të noterizuar. **Operatori Ekonomik i cili është shpërblyer me kontratë, nuk ka ofruar Certifikatë origjinale apo të noterizuar, por vetëm disa certifikata kopje.** Mos ofrimi i certifikatës përkatëse nga Operatori Ekonomik në ofertën e tij, me automatizëm këtë ofertë e bënë “Ofertë të Papërgjegjshme”.

Autoriteti Kontraktues, në Raportin e vlerësimit ka futur një rubrikë (Autorizimi, licenca apo anëtarësia në organizatë) e cila nuk ishte paraparë në Dosjen e Tenderit. Sipas kësaj evidence, të gjithë Operatorët Ekonomik figuron se e kanë plotësuar këtë kriter, ndërsa Agjencia Kundër Korrupsion nuk ka mundur të gjejë dokumentacion me emërtimin përkatës.

Autoriteti Kontraktues në këtë procedurë prokurimi, tek pika IV.3 Informacionet Administrative, ka kërkuar pagesë prej 10 €. Agjencia Kundër Korrupsion konsideron se është e pa nevojshme një pagesë e tillë, ngase shpenzimet për prodhimin e materialit të tenderit janë standarde dhe nuk përmbajnë modele apo numër të madh të kopjeve teknike.

Komisioni i vlerësimit ka përpiluar dokument (09 Nr.320) për gjendjen në terren të Operatorëve Ekonomik, dokumenti është i datës 29/10/2013, ndërsa në dokument figuron se vizita tek



operatorët Ekonomik është bërë nga data 26/10/2013 deri më 31/10/2013. Data e përpilimit të raportit nuk është dashur të jetë më herët sesa data e fundit e vizitës në terren.

Oferta e Operatorit fitues Ekonomik është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor (14/10/2013), ndërsa dokumentacionin (certifikatën fito sanitare) e ka sjellë më datë 30/10/2013, e cila është e inkorporuar në ofertën e dorëzuar paraprakisht. Gjithashtu, Operatori Ekonomik është shpërblyer me Kontratë edhe pse në Certifikatën e Biznesit nuk ka veprimtari për shitjen e fidanëve.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë që bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi; Neni 48 Dorëzimi i Dosjes së Tenderit; Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve; dhe Neni 67 Provat Shkresore të ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042.

Shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedurat e prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon mos nënshkrimin e kësaj kontrate si dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoriteti Kontraktues e informon Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!

